

Matrica e Monitorimit Mbi Mjedisin Mundësues Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për Shqipërinë
2020



monitoring
matrix

Matrica e Monitorimit Mbi Mjedisin Mundësues Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për Shqipërinë 2020

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Qershor 2020



Ky projekt bashkë-financohet
nga Bashkimi Evropian



Publikuesi: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Grupi i Vëzhgimit

Arbana Dibra

Enela Mone

Kristina Lato

Xhoana Zeqo

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Arbana Dibra

Enela Mone

Xhoana Zeqo

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha

Klotilda Kosta

Kostandina Këruti

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Adresa: Macedonia Street 43-1/9, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

Telefon: +389 2 6144 211

Email: executiveoffice@balkancsd.net

Website: www.balkancsd.net

www.monitoringmatrix.net

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Adresa: Rruga e Elbasanit, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73, Tirana

Telefon: 00355 4 2254 881

Email: partners@partnersalbania.org

info@resourcecentre.al

Ëëbsite: www.partnersalbania.org

www.resourcecentre.al

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të drejtat e rezervuara. Tirana, Albania 2021.

Një version është i disponueshëm në faqen e Partnerëve Shqipëri: <https://partnersalbania.org>, tek Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile: www.resourcecentre.al, tek Rrjeti BCSDN: www.balkancsd.net dhe: www.monitoringmatrix.net

Ky raport është pjesë e aktiviteteve të projektit “Protecting Civic Space – Regional Civil Society Development Hub”, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) në bashkëpunim me anëtarët e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi; dhe pjesë e aktiviteteve të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Partnerët Shqipëri në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian dhe pozicionin zyrtar dhe opinionin e SIDA.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	6
Mirënjohe	7
Vështrim i Përgjithshëm i Vendit	8
Përmbledhje Ekzekutive	10
Rreth Shoqërisë Civile	11
Gjetjet kryesore	12
Rekomandimet kryesore	13
Gjetjet	14
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive	14
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OShC-të	27
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet-OSHC	42
Konkluzione dhe Rekomandime	50
Bibliografi	53
Shtojcat	57
1. Metodologjia e Matricës së Monitorimit	57
2. Shënime mbi metodologjinë dhe sfidat shtetërore	60

Akronime

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BCSDN	Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
BE	Bashkimi Evropian
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoretë Rajonale të Tatimeve
KiE	Keshilli i Europës
VF	Vit Fiskal
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Matrica e Monitorimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PSH	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
QKBSHC	Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Hyrje

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri dhe Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile kanë kënaqësinë të paraqesin edicionin e tetë të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, duke mbuluar zhvillimet kryesore në Shqipëri, gjatë vitit 2020.

Ky raport është pjesë e një seri raportesh vendore që mbulojnë shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia. Gjithashtu, një raport rajonal që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet kryesore për të gjitha vendet dhe një platformë interneti që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve janë të disponueshme tek www.monitoringmatrix.net

Matrica e Monitorimit, e zhvilluar në 2013 nga BCSDN me mbështetjen e anëtarëve të saj, partnerëve, prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe mundësues për veprimtarinë e OShC-ve. Matrica është e organizuar në tre fusha, secila e ndarë sipas nën-fushave¹:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OShC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri - OSHC.

Parimet, standardet dhe indikatorët mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe në praktikën rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të zhvillohet dhe funksionojë në mënyrë efektive. Matrica synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist, i cili mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimin praktik të tij.²

Hulumtimi i kryer nëpërmjet MM synon të sigurojë raportime hije mbi mjedisin mundësues për OSHC-të dhe të ndikojë në politikën e zgjerimit dhe në mbështetjen financiare drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit.

¹ Si një mjet hulumtimi për matjen e mjedisit mundësues ligjor, rregullator dhe financiar në të cilin veprojnë OShC-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, Matrica synon t'i përgjigjet nevojës së OShC-ve për të pasur produkte kërkimore të bazuara në të dhëna konkrete dhe kapacitete për të advokuar drejt një mjedis më mundësues për shoqërinë civile.

² Për këto qëllime, brenda gjetjeve, raporti bën referenca dhe korrelacione të mëtejshme me Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në vendet e Zgjerimit, 2014-2020.

Mirënjohje

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile - Raporti për Shqipërinë 2020 është përgatitur nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKBSHC) në bashkëpunim dhe me mbështetjen e OSHC-ve.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri dëshirojnë tu shprehin mirënjohjen e tyre drejtorëve ekzekutivë dhe menaxherëve të nivelit të lartë të OShC-ve të cilët morën pjesë në këtë studim me një kampion prej 121 OSHC, duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e dedikuar si dhe falenderon për bashkëpunimin dhe korrektesinë institucionet publike që iu përgjigjën kërkesave për informacionin e kërkuar.

Vështrim i Përgjithshëm i Vendit

Në Mars 2020, anëtarët e Këshillit Evropian miratuan vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme për të hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe në korrik 2020 drafti i kuadrit të negociatave, i cili përcakton udhëzimet dhe parimet që rregullojnë negociatat e pranimit me vendin kandidat u paraqit para vendeve anëtare³. Pas miratimit të kuadrit, duhet të mbledhet konferenca e parë ndërqeveritare mbi Shqipërinë, para zhvillimit të së cilës Shqipërisë i kërkohet të bëjë përparim të mëtejshëm në reformat zgjedhore dhe kushtetuese si dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në 9 Mars 2020, u shënuan dy rastet e para të infektimit me koronavirus në Shqipëri. Në fillim të pandemisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik përgatitën një Plan Veprimi për Parandalimin, Përgatitjen dhe Përgjigjen ndaj virusit COVID-19. Plani u pasua nga vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24 Mars 2020 "Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore"⁴, që i dha mundësi qeverisë shqiptare të vendosë masa parandaluese dhe kufizuese për të penguar përhapjen e infeksionit. Këto masa përfshinin mbylljen e veprimtarive publike siç ishin mbyllja e institucioneve arsimore (çerdhe, kopshte, shkolla dhe universitete); ndalim i lëvizjes së lirë brenda vendit; lëvizje e pezulluar përmes detit, ajrit dhe tokës drejt shteteve fqinje, përveç lëvizjes së mallrave; mbyllja e bareve, restoranteve, xhamive, kishave dhe ndalimi i të gjitha sporteve dhe tubimeve me frekuentim të gjerë. Orët e ndalimit të qarkullimit gjatë ditëve të javës dhe masat e mbylljes së vendit gjatë fundjavës u vendosën për të minimizuar dhe kufizuar lëvizjet e qytetarëve. Si rezultat i masave të marra për të përballuar situatën e COVID-19, të cilat mund të interpretohet si shkelje e nenit 8 dhe nenit 11 (liria e tubimit dhe organizimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), autoritetet shqiptare deklaruan një derogim prej Konventës (neni 15 - Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme). Gjendja e jashtëzakonshme e fatkeqësisë natyrore u zgjat deri në qershor 2020 dhe pas kësaj, bazuar në rekomandimet e Komitetit Teknik të Ekspertëve mbi situatën COVID-19, u miratuan një sërë aktesh ligjore.

Për të mbështetur njerëzit dhe kompanitë e prekura nga situata pandemike, qeveria miratoi dy paketa financiare me një shumë totale prej 45 miliardë lekësh, rreth 2.8% të PBB-së së Shqipërisë. Paketa e parë konsistoi në fonde shtesë për sektorin e shëndetësisë, mbështetje për bizneset e vogla që u detyruan të mbyllnin aktivitetin e tyre, ndihma humanitare si dhe fondi i garancisë sovrane për të siguruar huadhënie për kompanitë. Paketa e dytë konsistoi në mbështetjen financiare për sigurimin e një pagese të vetme për punonjësit e bizneseve të vogla të prekura nga pandemia dhe një garanci sovrane për sigurimin e huadhënies për të gjitha kompanitë private që kishin paguar detyrimet e tyre tatimore përpara pandemisë. Mbështetja financiare u miratua gjithashtu për sektorin e transportit publik të prekur nga kufizimet si

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en

⁴ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=7793>

rezultat i COVID-19. OShC-të, përfshirë ato që e zhvillojnë aktivitetin e tyre si ndërmarrje sociale, nuk u përfshinë në asnjë nga skemat financiare të qeverisë për të adresuar ndikimin e situatës pandemike COVID-19 në aktivitetin e tyre.

Në lidhje me OShC-të, duke marrë parasysh "realitetin e ri" të krijuar si rezultat i COVID-19 dhe të gjitha kufizimet që janë zbatuar që nga Marsi i vitit 2020, OShC-të janë përballur me disa sfida në funksionimin dhe zbatimin e projekteve të tyre. Përkundër kësaj, shumica e OShC-ve janë përshtatur me realitetin e ri dhe aktualisht janë plotësisht të angazhuara me aktivitete online dhe "hibride". OShC-të kanë qenë shumë aktive në përgjigjen ndaj nevojave të përfituesve të tyre duke zhvilluar qasje alternative për t'u ofruar shërbimet e tyre individëve, familjeve dhe grupeve në nevojë. Ato kanë mbështetur qeverinë, veçanërisht qeverinë vendore, në identifikimin dhe shpërndarjen e mbështetjes për grupet e marginalizuara në shoqëri.

Për më tepër, OShC-të kanë qenë shumë aktive në monitorimin e zhvillimeve të kuadrit ligjor që ndikojnë në të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, mbështetësve dhe funksionimin e tyre. Në shumë raste, OShC-të kanë ngritur shqetësimet e tyre duke kërkuar një nivel më të lartë transparence dhe llogaridhënie nga qeveria dhe institucionet publike në lidhje me disa nisma të rëndësishme ligjore që janë ndërmarrë gjatë vitit 2020 me procedurë të përsheptuar dhe pa proceset e duhura të konsultimit me qytetarët dhe shoqërinë civile. Për t'u përmendur janë ndryshimet e propozuara në Kodin Penal për parandalimin e pandemisë COVID-19, e cila u kundërshtua nga një grup prej 30 organizatash, të cilat publikuan një deklaratë duke argumentuar se ndryshimet e propozuara shkelin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Për më tepër, miratimi i ndryshimit përmes një procedure të përsheptuar nga parlamenti u konsiderua në kundërshtim me Kushtetutën Shqiptare (neni 83, pika 3). Si rezultat i këtyre përpjekjeve, qeveria u tërhoq nga propozimet fillestare dhe lehtësoi disa masa.

Një seri nismash ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e OShC-ve u iniciuan nga qeveria në vitin 2020, në përgjigje të rekomandimeve të MONEYVAL (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave), të dhëna në Raportin e Vlerësimit të Ndërsjellë të korrikut 2018, si më poshtë: Ligji nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", Ligji Nr. 154/2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare", dhe projektligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse". Të gjitha këto nisma, megjithë rëndësinë e tyre thelbësore për sektorin, janë iniciuar dhe përgatitur pa pjesëmarrjen dhe konsultimin efektiv të OShC-ve. Pavarësisht kësaj, nën koordinimin e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, OShC-të ofruan komentet e tyre mbi Ligjin Nr. 154/2020 përpara miratimit të tij, disa prej të cilave u reflektuan në draftin përfundimtar të miratuar nga parlamenti. Projektligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" tërhoqi vëmendjen më të madhe të OShC-ve për shkak të implikimit të tij në funksionimin e sektorit dhe një sërë çështjesh të identifikuara, disa prej të cilave ndikojnë në lirinë e organizimit, dublikimit dhe kërkesat e pajustificuara të raportimit, përfshirë sanksionet disproporcionale dhe të pajustificuara. Projektligji është ende në pritje të miratimit nga parlamenti.

Përmbledhje Ekzekutive

Rreth Shoqërisë Civile

	2019	2020
Numri i organizatave të regjistruara	11,739 OSHC (313 OSHC të reja të regjistruara në vitin 2019)	11,962 OSHC (223 OSHC të reja të regjistruara në vitin 2020)
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	Ligji Nr. 8788 "Për Organizatat Jofitimprurëse" Ligji Nr. 8989 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" Kodi Civil i Shqipërisë Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse Ligji për të Drejtën e Informimit Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	
Ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor	Udhëzimi Nr. 34, datë 02.12.2019 "Për një Modifikim të Udhëzimit Nr. 6, Datë 30.01.2015" Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar" (Rimbursimi i TVSH-së) Udhërrëfyesi për shoqërinë civile	Ligji Nr. 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit" i ndryshuar Projektligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" Ligji Nr.112 / 2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues" Ligji Nr. 154/2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare" Ligji 162/2020 "Për Prokurimin Publik"
Financimi shtetëror (për vitin e kaluar) (organet kryesore dhe shumat)	Për vitin 2019, buxheti i AMSHC-së i alokuar për OSHC-të ishte rreth 100 milion lekë (afërsisht 793,000 EUR).	Për vitin 2020, buxheti i AMSHC-së i alokuar për OSHC-të ishte rreth 61 milion lekë (afërsisht 491,000 EUR).
Burimet njerëzore (të punësuar dhe vullnetarët)	9, 966 të punësuar Asnjë informacion mbi numrin e vullnetarëve	9,793 të punësuar Asnjë informacion mbi numrin e vullnetarëve
Bashkëpunimi OSHC-Qeveri (organi i rëndësishëm dhe i ri: mekanizëm konsultimi)	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile	
Sfida e tjera kryesore (p.sh. mungesa e të dhënave zyrtare në lidhje me shoqërinë civile)	- Nuk ka të dhëna të unifikuara dhe të sakta mbi OSHC-të - Lehtësirat financiare dhe qëndrueshmëria e sektorit mbetet një pikë e dobët. - Sektori është i varur nga donatorët, dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të tyre.	- Mbirregullimi i sektorit në kuadër të parandalimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. - Nuk ka të dhëna të unifikuara dhe të sakta mbi OSHC-të - Lehtësirat financiare dhe qëndrueshmëria e sektorit mbetet një pikë e dobët. Sektori është i varur nga donatorët dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të tyre - Regres në transparencë dhe llogaridhënie në aspektin e mbështetjes financiare shtetërore të OSHC-ve

Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të raportit

1.	Projektligji i ri "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" prezantoi regjistrimin elektronik të OShC-ve. Ai u përgatit përmes një procesi jo-gjithëpërfshirës dhe nuk mori në konsideratë disa rekomandime të rëndësishme që përfaqësojnë kufizim të lirisë së organizimit dhe funksionimit të OShC-ve.
2.	OShC-të ishin subjekte të ligjeve, pjesë e paketës të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit që u aprovua në vitin 2020. Paketa u kalua me shpejtësi, pa kaluar në procese konsultimi.
3.	Kuadri ligjor në fuqi vazhdon të mos njohë aktivitetin filantropik dhe dhurimet individuale si të zbritshme nga tatimi mbi të ardhurat personale. Nuk ka sistem që mbledh të dhëna zyrtare mbi dhurimet individuale dhe të biznesin ndaj OShC-ve.
4.	Financimi publik i alokuar për OShC-të nga institucionet publike u zvogëlua rreth 40% dhe si rrjedhojë ai vështirë se plotëson nevojat e sektorit për të adresuar çështjet e lidhura me COVID-19. Shpërndarja e financimit publik vazhdon të mos jetë transparente.
5.	Shumica e masave në Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile të planifikuara për vitin 2020 nuk u zbatuan.
6.	Ligji i ri 162/2020 "Për Prokurimin Publik" prezanton një kapitull të veçantë për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera të veçanta, duke lejuar një pjesëmarrje më të madhe dhe kuptimplotë të OShC-ve në procedurat e tenderimit publik.

Rekomandimet kryesore

Rekomandimet kryesore të raportit

1.	Parlamenti shqiptar duhet të angazhohet në një dialog të hapur dhe konstruktiv me OShC-të për të adresuar të gjitha shqetësimet në lidhje me projektligjin "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" përpara miratimit të tij.
2.	Shteti duhet të përdorë një qasje të bazuar në risk lidhur me masat PPP/LFT për sektorin e OJF-ve.
3.	Kuadri ligjor dhe rregullator duhet të amendohet për të njohur aktivitetin filantropik dhe për të ofruar stimuj tatimorë për bizneset dhe individët që janë dhurues të OShC-ve.
4.	Shteti duhet të rrisë fondet e financimit publik për të mbështetur aktivitetet e OShC-ve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vështirësive të krijuara nga COVID-19. Institucionet publike duhet të rrisin transparencën mbi shpërndarjen e fondeve tek OShC-të.
5.	Qeveria duhet të tregojë vullnet dhe angazhim më të fortë politik në zbatimin e planit të veprimit të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.
6.	OShC-të duhet të rrisin njohuritë dhe kapacitetet e tyre për një përfshirje më të madhe në procedurën e tenderimit publik për shërbimet sociale, duke përfutur nga mundësitë e reja të ofruara nga ligji i ri për prokurimin publik.

Gjetjet

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Nënfusha 1.1. Liria e organizimit

1.1.1. Themelimi dhe pjesëmarrja në OSHC

OSHC-të në Shqipëri e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin ekzistues, i cili përfshin, por nuk kufizohet në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar⁵ Kodin Civil, të ndryshuar⁶, Ligji Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar (Ligji 8788/2001)⁷ dhe Ligji Nr. 8789 datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" (Ligji 8789/2001)⁸.

Procesi i regjistrimit dhe ri-regjistrimit është i centralizuar dhe kryhet vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e bërë procesin të kushtueshëm dhe afatgjatë në kohë për OSHC-të që kanë seli jashtë Tirane. Sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, numri i përgjithshëm i OSHC-ve të regjistruara është 11,962 OSHC. Gjatë vitit 2020, janë regjistruar 138 shoqata, 63 qendra dhe 22 fondacione. Gjithashtu, 68 kërkesa për regjistrim janë refuzuar nga Gjykata, ndërsa 44 kërkesa u janë kthyer aplikantëve.⁹ Gjykata nuk dha asnjë informacion mbi arsytet e refuzimeve ose kthimeve.

Pas regjistrimit në Gjykatë, OSHC-të duhet të regjistrohen gjithashtu tek autoritetet tatimore. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) janë **4,972 OSHC në total të regjistruara**, nga të cilat vetëm **2,185 kanë status aktivë**. Gjatë vitit 2020 në DPT u regjistruan **186 OSHC të reja**. Në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,¹⁰ OSHC-të e regjistruara pranë autoriteteve tatimore duhet të hapin një llogari bankare dhe ta deklarojnë atë tek Autoritetet Tatimore. OSHC-të e reja të regjistruara, duhet të hapin një llogari bankare brenda 20 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre (neni 59 (1/3)).

Lidhur me aspektin praktik të procesit të regjistrimit, për shkak të masave të zbatuara për të

⁵ <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

⁶ <https://qbz.gov.al/preview/f010097e-d6c8-402f-8f10-d9b60af94744>

⁷ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2013/36/9b9fbd51-02a4-4cc5-8295-c6d6770b0582;q=ligji%2092%2F2013>

⁸ Ligji nr. 8789 datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin E Organizatave Jofitimprurëse"

⁹ Gjykata nuk dha asnjë informacion në kohën kur kanë ndodhur këto refuzime

¹⁰ <https://qbz.gov.al/preview/18d5cd2e-41ac-4ab9-b176-94c3965ab469/cons/20200925>

parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pezulloi funksionimin e saj nga muaji mars deri në maj të vitit 2020, gjë që mund të ketë ndikuar në uljen e numrit të OShC-ve të regjistruara krahasuar me një vit më parë (313 shoqata, qendra dhe fondacione në 2019, përkundrejt 223 në 2020).

Lidhur me grupet informale, përveç vështirësive si pasojë e pandemisë COVID-19, asnjë rast ndalimi të ushtrimit të aktiviteteve të tyre nuk është identifikuar në praktikë. Vetëm nëpërmjet projektit LevizAlbania¹¹, 18 grupe informale janë mbështetur për të zbatuar planet e tyre lokale të veprimit gjatë vitit 2020.

Përsa i përket koalicioneve dhe rrjeteve, fakti që kuadri ligjor nuk parashikon ndonjë dispozitë mbi formimin dhe regjistrimin e tyre nuk i ka penguar OShC-të të krijojnë dhe / ose të marrin pjesë në rrjete ose koalicione, si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare. Të dhënat nga hulumtimi i kryer nëpërmjet MM tregojnë se 85% e 121 OShC-ve të anketuara janë anëtare të rrjeteve dhe koalicioneve kombëtare, ndërsa 64,5% e tyre janë anëtare të rrjeteve dhe koalicioneve ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto rrjete bëhet pa asnjë kufizim nga shteti. Por, ende ka paqartësi ndërmjet OShC-ve rreth formës më të mirë ligjore të organizimit që do të përdoret në rastin e regjistrimit të një rrjeti.

Situata pandemike ndikoi në punën e OShC-ve, pasi 88% e 121 OShC-ve të anketuara deklaruan se u përballen me sfida të shumta për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Disa nga sfidat kryesore që ato kanë përmendur përfshijnë vështirësitë për të aksesuar përfituesit e tyre (71%), mungesa e mundësive të financimit (57%) dhe ndërprerja e zbatimit të projektit (36%).

Në qershor të vitit 2020, Ministria e Drejtësisë publikoi në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, projektligjin e ri "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", që parashikon krijimin e regjistrit elektronik dhe regjistrimin elektronik të OShC-ve, administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Regjistri elektronik synon të jetë i aksesueshëm nga publiku. Projektligji konsideron Regjistrin e OShC-ve si domenin qendror ku depozitohen të gjitha dokumentet e krijimit të organizatës, raportet financiare dhe të veprimtarisë së saj.

Regjistri elektronik ka qenë një kërkesë e hershme e OShC-ve në Shqipëri, duke njohur rëndësinë e tij në sigurimin e transparencës së sektorit dhe rritjen e besimit të publikut. Ai është përfshirë gjithashtu si në Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile 2015 - 2018 dhe Udhërrëfyesin 2019 - 2023 si një nga masat nën Prioritetin 7: Grumbullimi dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile.

Megjithë rëndësinë që mbart, projektligji në fazën e tij fillestare nuk u konsultua me OShC-të. Qeveria zhvilloi një proces të përshpejtuar për shkak të nevojës për t'iu përgjigjur rekomandimeve të MONEYVAL.

¹¹ <https://www.levizalbania.al/sq/nisma-te-mbeshtetura>

Projektligji u mirëprit nga sektori i OShC-ve, por procesi nuk ishte gjithëpërfshirës dhe nuk reflektoi propozimet e OShC-ve. Ministria e Drejtësisë (MD) si përgjegjëse për hartimin e projektligjit, e kufizoi procesin e konsultimit në publikimin e tij në regjistrin elektronik të konsultimit. Një grup OShC-sh, nën udhëheqjen e PSH dhe QKBSHC paraqitën një sërë rekomandimesh dhe çështjesh shqetësuese në lidhje me projektligjin dhe arritën të dakordësonin një takim të minutës së fundit me përfaqësuesin e MD, përpara se projektligji të dërgohej në Këshillin e Ministrave. MD ra dakord me çështjet e ngritura dhe premtoi të rishikojë projektligjin. Vetëm kur projektligji u dërgua në Parlament, sektori kuptoi që shumë pak rekomandime ishin marrë në konsideratë. Grupi i OShC-ve paraqiti më pas një kërkesë për seancë dëgjimore me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut por parlamenti nuk dha asnjë përgjigje deri në datën që mbart ky raport. Projektligji është në pritje të miratimit nga parlamenti gjatë vitit 2021.

Projektligji bie ndesh me një nga dispozitat ligjore për organizatat e shoqërisë civile dhe parimin e lirisë së organizimit, në bazë të së cilit regjistrimi nuk është parakusht për të ushtruar të drejtën e organizimit. Projektligji u karakterizua nga një numër i lartë sanksionesh, të cilat u vlerësuan si jo proporcionale. Një shqetësim tjetër i ngritur nga OShC-të ishte e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kërkesat burokratike dhe të pajustificuara të raportimit nga OSHC-të tek institucionet publike.

1.1.2. Ndërhyrja e shtetit

Kuadri ligjor ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OShC-ve. Ligji 8788/2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" në nenet 6 dhe 7 të tij përcakton se OShC-të ushtrojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë e tyre nga institucionet dhe interesat shtetërore dhe se institucionet shtetërore nuk ndërhynë në veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Në praktikë, 4 nga 121 OSHC të anketuara shprehen se janë përballur me kontrolle inspektimi nga autoritetet publike pa njoftim paraprak, dhe 4 OSHC që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e medias dhe gazetarisë pohuan se kanë hasur kufizime në aksesin në internet, kryesisht bllokime dhe sulme të faqeve zyrtare të internetit dhe llogarive të mediave të tyre sociale.

Në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit mbi Organizatat Jofitimprurëse, një OShC mund të shpërndahet vullnetarisht përmes një vendimi të organit më të lartë vendimmarrës. Për më tepër, Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e një OShC-je kur veprimtaria e saj bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kur ka kryer veprimtari të kundërligjshme, kur nuk është krijuar në përputhje me kërkesat ligjore, ose kur ka falimentuar. Pas shpërndarjes, pasuritë e mbetura të organizatës do t'i kalojnë organizatave të tjera siç përcaktohet në vendimin e organit më të lartë vendimmarrës. Kur shpërndarja vendoset nga Gjykata, pasuritë e mbetura do të shkojnë për organizatat që ndjekin qëllime të ngjashme me ato të organizatës së shpërndarë. Gjykata vendos se cilat janë këto organizata.

Sipas Ligjit Nr. 97/2018, "Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"¹², Gjykata mund të procedojë me kërkesën e çregjistrimit të një organizate vetëm kur autoritetet tatimore konfirmojnë se organizata nuk ka asnjë detyrim tatimor të pushlyer. Sidoqoftë, nëse detyrime tatimore ekzistuese zbulohen pas çregjistrimit, autoriteti tatimor mund t'i vlerësojë ose mbledhë ato me forcë (Neni.45, pika 8), duke e konisderuar përfaqësuesin ligjor si përgjegjës, edhe pasi organizata është çregjistruar. Bazuar në informacionin e marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, **numri i përgjithshëm i OShC-ve të çregjistruara është 156 OShC.**

Në lidhje me raportimin e OShC-ve tek institucionet publike, OShC-të duhet të paraqesin pasqyra financiare vjetore. Konceptet dhe parimet kryesore për përgatitjen e pasqyrave financiare për OShC-të janë përcaktuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse.¹³ Standardi përcakton kërkesa të thjeshtuara raportimi për organizatat me të ardhura vjetore nën 5 milion lekë (afërsisht 40,650 EUR), të cilave u kërkohet të zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare, dhe të dorëzojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënimet shpjeguese lidhur me llojin e aktiviteve apo shërbimeve që ofrojnë.

Ligji Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 22, pika 1, përcakton se brenda 7 mujorit të vitit pasardhës të pasqyrave, OShC-të duhet të paraqesin për publikim në Gjykatë pasqyrat e tyre vjetore financiare, raportin e konsoliduar të veprimtarisë dhe raportin e auditimit, në rast se dokumente të tilla janë të detyrueshme, në bazë të legjislacionit në fuqi. Nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare tejkalon vlerën 30 milion lekë (rreth 241,000 EUR) OShC-të duhet të publikojnë pasqyrat financiare vjetore në faqen e tyre zyrtare të internetit. Ato gjithashtu duhet të përgatisin një raport të performancës në lidhje me veprimtarinë e tyre, i cili duhet të publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Në qershor të vitit 2020, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit publikoi modelin e raportit të performancës në lidhje me veprimtarinë e OShC-ve, i cili është i organizuar në pesë kapituj si më poshtë: 1) Objektivat dhe aktivitetet; 2) Arritjet dhe performanca; 3) Raportimi financiar; 4) Struktura, drejtimi dhe mbikëqyrja; dhe 5) Çështje të tjera që OShC-të kanë interes të ndajnë.

Në lidhje me sanksionet, në 2020 DPT ka vendosur 91 gjoba ndaj OShC-ve për shkelje të detyrimeve ligjore. Shumica e gjobave vendosen për mosdeklarim të punonjësve (43%) dhe mosdhënie të informacionit (30%), siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Nga 121 OShC të përfshira në vëzhgimin e MM, 17% e tyre (20 OShC) janë përgjigjur se kanë qenë subjekt i një sanksioni, nga të cilat 80% kanë deklaruar se sanksionet kanë qenë proporcionale me shkeljen, ndërsa 20% kanë deklaruar se sanksionet kanë qenë joproportionale me shkeljen. Arsytet përputhen me ato të paraqitura nga autoriteti tatimor, me

¹² <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=4458>

¹³ Udhëzim nr. 62, datë 17.09.2015 "Për Shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse dhe zbatimin e detyrueshëm të tij", Ministria e Financës, Gazeta Zyrtare 171/2015 [Online] https://qbz.gov.al/share/msVHnvi8QI-INGH_26ccqQ

vonesën në deklarim si arsyeja më e shpeshtë. Në disa raste, vonesat kanë qenë për shkak se sistemi online nuk ka funksionuar. Vetëm një organizatë e ka apeluar sanksionin e vendosur në Gjykatë.

Tabela 1: Sanksionet e vendosura ndaj OShC-ve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në vitin 2020

Arsyeja	Numri i sanksioneve
Dënim për mospajisje me pajisjet fiskale për herë të parë	1
Gjobë inspektori për mosdeklarim punonjësish	40
Gjobë inspektori TVSH Lëshim Fature Tatimore te Pasaktë	4
Gjoha për mosmbajtjen e saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit	9
Gjobë inspektori për evazion fiskal dhe fshehje detyrimi	2
Gjobë inspektori për mosdeklarim në organet tatimore të llogarive bankare për herë të dytë	4
Mosdhënia e informacionit	28
Tatimi mbi qeranë Gjoha inspektori Evazion fiskal dhe Fshehje Detyrimi	1
Te tjera tatime ne burim Gjoha inspektori Evazion fiskal dhe Fshehje Detyrimi	2

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Gjatë vitit 2020, janë miratuar disa nisma ligjore me ndikim për sektorin jofitimprurës, për të adresuar rekomandimet e MONEYVAL, si Ligji Nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues" (Ligji RPP)¹⁴, dhe Ligji Nr.154 / 2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare"¹⁵.

Sipas Ligjit RPP, i cili hyri në fuqi në dhjetor 2020, pronar përfitues do të konsiderohet çdo individ i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individi në emër të të cilit po kryhet një transaksion ose veprimtari, përfshirë themeluesin, ose përfaqësuesin ligjor ose individin që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e OShC-ve (neni 3 (1) (1.1.2) Ligji 112/2020). Të gjitha OShC-të duhet të regjistrojnë pronarët e tyre përfitues. Siç vërehet edhe nga eksperiencia e OShC-ve në vendet e tjera ku është zbatuar ky ligj, në Shqipëri terminologjia dhe konceptet e përdorura në ligj nuk marrin parasysh dhe nuk reflektojnë natyrën dhe karakteristikat e OShC-ve. Si rezultat, pritet që OShC-të të kenë vështirësi gjatë procesit të regjistrimit. Duke qenë se regjistri do të menaxhohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe pjesa informative e regjistrit për OShC-të menaxhohet tashmë nga Gjykata e

¹⁴ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=8716>

¹⁵ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=9590>

Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo konsiderohet si një barrë e shtuar administrative për sektorin. Që nga sot, çdo OSHC ka përgjegjësinë të pëditësojë informacionin në lidhje me organin vendimmarrës në të njëjtën kohë kundrejt Gjykatës dhe QKB-së.

Ligji "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare" përbën një instrument shtesë në luftën kundër pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Ligji mundëson krijimin e një regjistri qendror të llogarive bankare, përfshirë informacionin mbi llogaritë bankare dhe kasetat e sigurisë. Regjistri do të përfshijë gjithashtu llogari bankare të OSHC-ve. Të gjitha bankat e nivelit të dytë duhet të raportojnë çdo ditë tek DPT për statusin e llogarive bankare dhe mbajtësit e tyre. DPT do të jetë përgjegjëse për administrimin e këtij regjistri.

Projektligji nuk kaloi të gjitha fazat e duhura të një procesi konsultimi. Subjektet që i nënshtrohen ligjit, të cilat janë bizneset dhe përfaqësuesit e OSHC-ve shprehën shqetësime në lidhje me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke qënë se subjekti nuk njoftohet paraprakisht si dhe faktin se institucioni përgjegjës është DPT dhe jo banka qendrore. Ky i fundit si një institucion i pavarur do të garantonte të drejtat kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe interesin e partnerëve të përfshirë. Këto shqetësime dhe disa të tjera ishin pjesë e një letre pozicionimi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga QKBSH dhe PSH. Projektligji në vesionin final reflektoi disa nga rekomandimet e dhëna.

Çështja më problematike në ligj qëndron në të drejtën që ka DPT për të ofruar informacion për institucionet e tjera të interesuara pa aprovim paraprak nga Gjykata.

OSHC-të gjithashtu janë subjekte të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit nga autoritetet shtetërore në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Bazuar në udhëzimin për mbikëqyrjen e OSHC-ve në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë,¹⁶ Drejtoritë Rajonale të Tatimeve (DRT) raportojnë tek DPT çdo gjashtë muaj mbi OSHC-të që nuk janë regjistruar, ato me status pasiv dhe OSHC-të që nuk kanë dorëzuar deklaratat tatimore. Pas vlerësimit të çështjes, brenda 15 ditësh, njësia qendrore e DPT, ia përcjell atë Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) për analizë të thelluar të çështjeve. Udhëzimi përcakton gjithashtu që nëse DRT gjatë punës së tyre (kontroll në terren; rishikim i pasqyrave financiare, kontroll i veprimtarisë), identifikojnë raste financimi që paraqesin risk, raporton rastet e dyshuara në njësinë qendrore në DPT. Pas vlerësimit të rasteve, DPT i përcjell ato tek DPPPP sipas parashikimit ligjor të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

¹⁶ Udhëzimi nr. 19, datë 9.7.2019 "Për mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"

1.1.3 Sigurimi i burimeve financiare

Legjislacioni në fuqi u mundëson OShC-ve që të marrin dhe sigurojnë mbështetje financiare për aktivitetet e tyre nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, pa miratim dhe vlerësim paraprak nga shteti. Gjithashtu, OShC-të mund të angazhohen në veprimtari ekonomike, të marrin fonde nga burime vendase dhe të huaja si dhe nga burime private. Sikundër dhe në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit, dhurimet individuale nuk njihen nga asnjë dispozitë aktuale ligjore.


OShC-të mund të gjenerojnë të ardhura nga tarifatat për shërbimet, shitjet, qiratë, etj. Organizata jofitimprurëse mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që (i) kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës jofitimprurëse, (ii) të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe (iii) kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës (Neni.36 i Ligjit për OShC-të dhe Neni.56 / 1 i Kodit Civil Të Republikës Së Shqipërisë).

Siç është përmendur në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit, kuadri ligjor për ndërmarrjet sociale nuk favorizon funksionimin e tyre. Procedura për të marrë statusin e "ndërmarrjes sociale", mungesa e stimujve fiskalë edhe për ndërmarrjet sociale që punësojnë grupe të marginalizuara, shoqëruar me paqartësinë dhe kufizimet e parashikuara nga kuadri ligjor ekzistues vënë në pikëpyetje të madhe rritjen e ndërmarrjeve sociale në vend.

Për OShC-të që zhvillojnë veprimtari ekonomike, është e zbatueshme edhe kërkesa e shprehur në pikën 55.1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24 datë 2.09.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar ashtu sikundër dhe Ligji Nr. 18.12.2019 "Për faturimin dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" plotëson kuadrin ligjor në lidhje me dokumentacionin e çdo transaksioni dhe pagese, pavarësisht nëse ajo kryhet përmes sistemit bankar, sistemeve financiare jo-bankare ose pagesave të parave në dorë/cash. Duke filluar nga korriku 2021, i gjithë faturimi për OShC-të do të jetë elektronik dhe do të kryhet përmes platformës e-Albania.


Fondet nga burimet e huaja përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave për veprimtarinë e OShC-ve. Grafiku 1 tregon burimet e të ardhurave të OShC-ve gjatë vitit 2020. Siç vërehet, 71% e 121 OShC-ve të anketuara deklarojnë se kanë siguruar fonde nga ambasada, institucione të huaja private, etj. Fondet e Bashkimit Evropian renditen në vend të dytë me 54% dhe megjithëse nuk ka një rregullim ligjor për dhurimet individuale, 21% e OShC-ve deklaruan se kishin siguruar fonde nga këta të fundit. Duke iu referuar fondeve publike, 17% e OShC-ve deklaruan se ata kanë siguruar fonde nga institucionet e qeverisë vendore, ndërsa 10% e 121 OShC-ve të anketuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Grafiku 1: Burimet e të ardhurave të OShC-ve për vitin 2020



Në bazë të vëzhgimit, 12% nga 121 të OShC-ve të anketuara kryejnë veprimtari ekonomike. Gjetjet nga studimi bazë mbi karakteristikat dhe sfidat e ndërmarrjeve sociale tregojnë se shumica e ndërmarrjeve sociale ose nuk kanë qëllim të aplikojnë për statusin e ndërmarrjes sociale ose hezitojnë për shkak të burokracive dhe pasigurive që rrjedhin nga ligji¹⁷. Lidhur me burimin shtesë të financimit të OShC-ve në përgjigje të situatës pandemike COVID-19, 27 nga 121 OSHC të anketuara deklaruan se kanë marrë fonde shtesë. Të pyetur për burimin e financimit në kuadër të COVID - 19 (alternativa të shumëfishta), fondet nga donatorët e huaj përbëjnë burimin kryesor të financimit sipas këtij anketimi të OSHC-ve.

Grafiku 2: Burime shtesë financimi të OSHC-ve në përgjigje të COVID-19



¹⁷ http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/09/Characteristics_and_Challenges_of_Social_Enterprises_in_Albania_baseline_study.pdf

Kutia 1: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikave

1.1.c. Progresi në lidhje me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës

Lidhur me lirinë e organizmit, projektligji "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" u mirëprit nga sektori i OShC-ve, por nuk u zhvillua një proces gjithëpërfshirës dhe nuk u reflektuan sygjerimet e OShC-ve. Projektligji bie në kundërshtim me një nga dispozitat ligjore mbi organizatat e shoqërisë civile dhe parimin e lirisë së organizimit sipas të cilit regjistrimi nuk është parakusht për të ushtruar të drejtën e organizimit. Kostot e regjistrimit, duke përfshirë legalizimin e dokumenteve, pagesën e një personi juridik për të ndjekur procesin, etj., janë shumë të larta dhe variojnë në shumën prej 70,000 lekë (rreth 560 EUR).

Në lidhje me ndërhyrjen e shtetit, gjatë vitit 2020 u miratuan disa nisma ligjore që ndikojnë në sektorin jofitimprurës, duke adresuar rekomandimet e MONEYVAL. Pavarësisht nga rëndësia e tyre thelbësore për sektorin, ato janë nisur dhe përgatitur pa pjesëmarrjen dhe konsultimin efektiv të OShC-ve.

Nënfusha 1.2. Liri të Tjera

1.2.1. Liria e Tubimeve Paqësore

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 ndikoi në të drejtat dhe liritë e tjera themelore.

Në kuadër të masave të qeverisë për të parandaluar përhapjen e pandemisë COVID-19, bazuar në Aktin Normativ Nr. 3, datë 15 Mars 2020¹⁸, të gjitha aktivitetet publike, përfshirë grumbullimet dhe tubimet u ndaluan deri në 3 Prill 2020, për të mbrojtur shëndetin publik. Brenda të njëjtës ditë, Qeveria Shqiptare përmes Përfaqësuesit të saj të Përhershëm në Këshillin e Evropës, dërgoi një Notë Verbale, duke informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, për ushtrimin e së drejtës së Derogimit bazuar në nenin 15 të Konventës Evropiane Për Të Drejtat E Njeriut, si rezultat i masave të marra për të përballuar situatën e COVID - 19. Periudha e ndalimit u zgjat përmes disa urdhrave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSH), deri në 17 Nëntor 2020, kur ministria publikoi Urdhrin 633, datë. 17.11.2020, përmes së cilës u lejuan tubimet publike në hapësira të hapura dhe të mbyllura me pjesëmarrjen e deri në dhjetë (10) personave. Ky urdhër është ende në fuqi.

Pavarësisht kufizimeve, gjatë vitit 2020, qytetarët u organizuan ose morën pjesë në tubime. Bazuar në informacionin e marrë nga Policia e Shtetit **në total u organizuan 399 tubime** për çështje të ndryshme, përfshirë kundërshtimin e akteve normative dhe urdhrave të publikuara nga MSHMS për të parandaluar përhapjen e pandemisë COVID-19. Vetëm për 90 (22.5%) nga këto tubime, organizatorët paraqitën një njoftim në Policinë e Shtetit, siç parashikohet edhe në ligjin për tubimet. Nga këto, 37 njoftime u paraqitën nga OShC-të. Përsa i përket refuzimit të së drejtës për tubime, 49 njoftime u refuzuan nga Policia e Shtetit. Arsyeja kryesore e refuzimit ishte situata pandemike COVID-19, gjatë së cilës tubimet u ndaluan. Sipas informacionit të marrë nga Policia e Shtetit, 112 organizatorë dhe pjesëmarrës në 10 tubime janë ndaluar për kryerje të shkeljeve të ndryshme penale në përputhje me Kodin Penal.

Avokati i Popullit, si rezultat i situatës së krijuar nga masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe ndikimit të tyre në të drejtën e qytetarëve për t`u grumbulluar lirisht, Avokati i Popullit publikoi një letër¹⁹ me rekomandime për masat e nevojshme që institucionet publike duhet të marrin për të respektuar të drejtën për lirinë e tubimit paqësor. Letra iu drejtua Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Letra parashtrij një sërë rekomandimesh duke theksuar masat e nevojshme që Policia e Shtetit duhet të marrë për të ndërprerë praktikën e moslejimit të grumbullimeve jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si dhe për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

¹⁸ <https://partnersalbania.org/publication/effectiveness-in-covid-19-response-albania-case-study-report/>


¹⁹ Idem, 10

Gjithashtu, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për të bërë propozimet konkrete drejtuar organeve që kanë të drejtën e nismës legislative për të mundësuar ndryshimet në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, për të garantuar të drejtën e tubimeve spontane si dhe kundër-tubimet në përputhje me rekomandimet dhe aktet ndërkombëtare. Megjithatë, asnjë veprim ligjor nuk është ndërmarrë për të ndryshuar ligjin mbi tubimet. Në lidhje me ndalimet, Avokati i Popullit rekomandoi përgatitjen dhe miratimin e një udhëzimi nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për unifikimin e praktikave nga organet e prokurorisë dhe ato gjyqësore për ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.

Të dhënat nga vëzhgimi i Matricës e Monitorimit tregojnë se 43% e 121 OShC-ve të anketuara shprehen se kanë marrë pjesë në një tubim ose si organizatorë, ose si pjesëmarrës. Natyra e tubimeve ka qenë e larmishme dhe OShC-të kanë organizuar tubime mbi çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtat e grave dhe vajzave kundër abuzimit seksual, çështje mjedisore, protestë kundër vendimeve të qeverisë të konsideruara si të paligjshme, etj.

Siç tregohet më poshtë në Grafikon 3, shumica e OShC-ve nuk janë përballur me sfida kur kanë organizuar apo kur kanë marrë pjesë në tubime. Vetëm 18% e OShC-ve të anketuara janë përballur me kufizime për të aksesuar hapësirën e dëshiruar për organizimin e tubimit, 14% e tyre kanë përjetuar përdorim të forcës së tepruar nga policia dhe 10% e OShC-ve të anketuara raportuan raste të ndalimit të protestuesve gjatë tubimit. Rastet e forcës së tepruar të përdorur nga policia dhe ndalimet e protestuesve u raportuan në rastet e tubimit kundër shembjes së ndërtesës të teatrit kombëtar dhe një rast vrasje të një të riu nga një oficer policie.

Grafiku 3: Përvoja e OShC-ve me të drejtën e tubimit paqësor



1.2.2. Liria e Shprehjes

Paketa ligjore kundër shpifjes e propozuar nga Qeveria ka nxitur një debat të fortë publik në dy vitet e fundit, veçanërisht nga përfaqësuesit e mediave, gazetarët, OShC-të dhe organizatat ndërkombëtare pasi minon lirinë e shprehjes dhe i jep kompetenca të zgjeruara administrative Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në qershor të vitit 2020, Komisioni i Venecias publikoi një opinion rreth ligjit të qeverisë për rregullimin e medias online. Ndërsa në opinionin e dhënë nga Komisioni i Venecias pranohen përpjekjet e autoriteteve shqiptare për të qenë transparente, për t'iu përgjigjur kritikave dhe për të përmirësuar tekstin e projekt-ndryshimeve, Komisioni vlerëson se projekt-ndryshimet nuk janë gati për aprovim në formën e tyre aktuale. Ligji është i paqartë dhe ka të ngjarë të ketë një "efekt tronditës" duke shtypur fjalën e lirë dhe debatin politik në sektorin shqiptar të internetit²⁰. Pas kësaj, Qeveria u tërhoq nga nisma ligjore për përmirësime të mëtejshme, në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias.

Lidhur me lirinë e medias, Indeksi i Reporterëve pa Kufij 2020, e renditi Shqipërinë në pozicionin e 84-të, duke zbritur dy pozicione nga viti i kaluar. Raporti nënvizoi se qeveria ka rritur përpjekjet e saj për të kontrolluar median nën pretendimin e luftës kundër lajmeve të rreme dhe dezinformimit.

Lidhur me situatën pandemike COVID-19, media dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë kritikuar qeverinë për monopolizimin e informacionit gjatë periudhës pandemike. Në lidhje me këtë çështje, ka qenë pothuajse e pamundur të merret një informacion i pavarur dhe të ketë burime të besueshme verifikimi të informacionit. Media dhe organizatat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut i kanë konsideruar këto kufizime si antikushtetuese dhe të dëmshme²¹.

Bazuar në përgjigjen e tyre, pjesa më e madhe e 121 OShC-ve të anketuara (94%) nuk kanë hasur ndonjë problem me lirinë e shprehjes. Vetëm shtatë OSHC (6%) janë përballur me presione për fjalime kritike kundër qeverisë dhe entiteteve private, dhe tetë prej tyre (7%) janë vetëcensuruar. Shumica e organizatave që përballen me presione të tilla janë organizata të medias dhe OSHC-të me rol mbikëqyrës ("watchdog").

1.2.3. Aksesi në burimet e informacionit

Kuadri ligjor mundëson përdorimin e platformave online dhe internetit. Në Shtator 2020, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, autoriteti kombëtar përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollimin dhe monitorimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve të Internetit në Shqipëri²², miratoi Rregulloren për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Komunikimeve Elektronike Publike.²³ Kjo rregullore synon të krijojë dhe sigurojë mbrojtje më

²⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)013-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e)

²¹ <https://partnersalbania.org/publication/effectiveness-in-covid-19-response-albania-case-study-report/>

²² https://www.akep.al/wp-content/uploads/2020/09/Rregullore-per-Mbrojtjen-e-Konsumatoreve-te-komunikimeve-elektronike_Keshillim-Publik.pdf

²³ <https://www.akep.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendim-nr.20-date-25.09.2020-per-Miratimin-per-Keshillim-Publik-te-Rregullore-per-Mbrojtjen-e-Konsumatorit-komunikime-elektronike1.pdf>

të mirë për konsumatorin dhe përdoruesit që përdorin komunikimet elektronike.

Në lidhje me aksesin në internet, ka 2.07 milion përdorues të internetit në Shqipëri, dhe përdorimi i internetit është në nivelin 72%²⁴.

Në kohën e pandemisë COVID-19 kur nevoja për zgjidhje në aspektin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është e lartë, OShC-të duhet të jenë të gatshme të përballen me këtë sfidë, planifikimi i duhur financiar dhe zhillimi i aftësive në fushën e TIK, është një përparësi për OShC-të në Shqipëri. Në përgjigje të kësaj, PSH dhe QKBSHC ofruan një paketë të mbështetjes së shpejtë për sektorin. Paketa e mbështetjes përmbante dy ndërhyrje kryesore:

(1) Akses një vjeçar në Platformën Zoom, kostot e së cilës u mbuluan nga PSH dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

(2) Trajnime online për përdorimin e një sërë platformash online dhe mjeteve krijuese. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të aplikacioneve, mjeteve dhe platformave të disponueshme, në shumicën e rasteve, është e vështirë të zgjedhësh të duhurën. Si pjesë e këtij trajnimi, pjesëmarrësit kanë mundësinë të njihen me platformat, të vlerësojnë se cilat janë të përshtatshme dhe më ekonomike në përputhje me nevojat e tyre.

Kutia 2: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikave

1.1.c. Progresi në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 ndikoi në të drejtat dhe liritë e tjera themelore.

Në lidhje me lirinë e tubimit, gjatë vitit 2020 u organizuan 399 tubime në total, dhe 112 organizatorë dhe pjesëmarrës në 10 tubimet u arrestuan nga Policia e Shtetit për kryerjen e shkeljeve të ndryshme penale sipas Kodit Penal. Rastet e përdorimit të forcës së tepruar nga policia dhe ndalimet e protestuesve u raportuan edhe nga OShC-të e anketuara përmes raportit të MM, si në rastin e protestave kundër prishjes së ndërtesës së teatrit kombëtar apo vrasjes së një të riu nga një oficer policie.

Në lidhje me lirinë e shprehjes, media dhe organizatat e të drejtave të njeriut kanë kritikuar qeverinë për monopolizimin e informacionit në lidhje me pandeminë COVID-19. Në lidhje me këtë çështje, ka qenë pothuajse e pamundur të merret një informacion i pavarur dhe të ketë burime të besueshme të verifikimit të informacionit. Media dhe organizatat e të drejtave të njeriut i kanë konsideruar këto kufizime si antikushtetuese dhe të dëmshme.

²⁴ <https://datareportal.com/reports/digital-2020-albania>

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OShC-të

Nënfusha 2.1. Trajtimi tatimor / fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

2.1.1. Përfitimet tatimore

Trajtimi fiskal dhe rimbursimi i TVSH-së ishte një nga çështjet e ngritura nga OShC-të në "Konferencën Kombëtare për Shoqërinë Civile në Shqipëri 2020"²⁵ të organizuar nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në dhjetor 2020. *Trajtimi fiskal i sektorit (përfshirë rimbursimin e TVSH-së për grante) ende përbën një shqetësim dhe po ndikon negativisht në veprimtarinë e OSHC-ve duke tkurrur aktivitetet e OShC-ve.*

Prioriteti 9 i Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, ka të bëjë me raportimin financiar / kontabilitetin dhe trajtimin tatimor të OShC-ve. Ekzistojnë 4 masa nën këtë prioritet, si në vijim: (i) heqja e detyrimit ligjor për OShC-të për të pasur një staf të paguar edhe në rastet kur ata punojnë vullnetarisht, (ii) harmonizimi i akteve nënligjore me ligjin e ri të TVSH-së për trajtimin e TVSH-së së OShC-ve, (iii) përgatitja e një Manuali për Kontrollin e Taksave për inspektorët tatimorë të ngarkuar me raportimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të OSHC-ve, (iv) ndryshimi i Ligjit mbi Sponsorizimin dhe ligjeve të tjera fiskale për të njohur përfitimet tatimore për të gjitha dhurimet kundrejt OShC-ve. Asnjë nga këto masa nuk është adresuar brenda vitit 2020, siç është parashikuar në Planin e Veprimit të Udhërrëfyesit.

OShC-të mund të angazhohen në veprimtari ekonomike, por ky nuk duhet të jetë aktiviteti kryesor i OShC-ve dhe të ardhurat vjetore nga veprimtaria ekonomike nuk duhet të kalojnë 20% e të ardhurave totale vjetore. Si çdo person i tatueshëm, OShC-të kanë të drejtë të kërkojnë rimbursimin e TVSH-së për aktivitetin e tyre ekonomik, nëse plotësojnë të dy kriteret e përshkruara në ligjin e TVSH-së: 1) tepriçë kreditore të TVSH-së e mbartur për tre muaj të njëpasnjëshëm; dhe, 2) shuma e kërkuar për rimbursim duhet të kalojë 400,000 lekë (afërsisht 3,300 EUR). Lidhur me kërkesat administrative për të aksesuar përfitimet tatimore mbi aktivitetin e tyre ekonomik, 46% e OShC-ve të anketuara që kryejnë veprimtari ekonomike (6 OSHC nga 121 OSHC të anketuara) u shprehën se kërkesat janë të vështira për tu përmbushur, ndërsa 31% u përgjigjën se kërkesat administrative janë disi të vështira për tu përmbushur.

²⁵ <https://resourcecentre.al/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2019/>


OSHC-të duhet të plotësojnë tre kritere njëkohësisht për t'u kualifikuar për përjashtimin e TVSH-së: (1) Organet vendimarrëse nuk duhet të kenë interesa të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës (2) veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) duhet të mbizotërojë dukshëm mbi veprimtarinë ekonomike, (3) shumica e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike, si një veprimtari dytësore e saj, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës. Procedura e përjashtimit nga TVSH-ja (Neni. 3) kërkon dorëzimin në DRT të një sërë dokumentesh si vendimi i gjykatës, statuti dhe akti i themelimit, një listë të të gjitha shërbimeve dhe produkteve të ofruara si dhe çmimet, deklaratën e misionit dhe fushat kryesore programatike, listën e grupeve përfituese, burimet e të ardhurave duke përfshirë të ardhurat që rrjedhin ose që priten nga aktiviteti ekonomik. Përjashtimi nga TVSH-ja është i vlefshëm për 3 (tre) vjet me të drejtë rinovimi. Kur aplikohet për herë të parë, statusi është i vlefshëm për 1 (një) vit.

Vendimi Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014", "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 13), shfuqizoi Vendimin e Qeverisë Nr. 1679, datë 24.12.2008, "Për Kriteret Dhe Procedurat E Përcaktimit Të Statusit Të Organizatave Jofitimprurëse Për Përfitim Publik ", dhe vendosi kritere të reja për përjashtimin nga TVSH-ja për aktivitetet furnizuese të OSHC-ve (Neni. 2). Ky lloj aktiviteti duhet të ketë një natyrë sociale, arsimore, kulturore ose sportive. OShC-të që kryejnë veprimtari ekonomike të përjashtuara nga TVSH-ja siç janë shërbimet shëndetësore dhe arsimore në përputhje me Nenin. 51, Ligji Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 'Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë,' përjashtohen nga kjo procedurë. Shërbimet dhe mallrat duhet të ofrohen bazuar në çmimet e miratuara nga autoritetet kompetente. Në rastet kur çmimet nuk miratohen, ato duhet të jenë më të ulta se çmimet e tregut për të njëjtat shërbime. Përjashtimi nga TVSH-ja nuk zbatohet për shërbimet dhe mallrat e blera nga OSHC-ja si pjesë e aktivitetit të saj ekonomik, por zbatohet për mallrat e importuara për hir të aktivitetit të saj jofitimprurës.

Gjithashtu, nëse të ardhurat vjetore të OShC-së tejkalojnë kufirin prej 2 milion lekësh (afërsisht 36,000 EUR), ato duhen të regjistrohen për TVSH-në sipas ligjit mbi procedurat tatimore, të ndryshuar në vitin 2018. Për shkak të situatës pandemike, duke filluar nga 1 janari 2021, kufiri i regjistrimit në skemën e TVSH-së është 10,000,000 lekë. Bazuar në informacionin e marrë nga DPT, 1,262 OSHC janë regjistruar në skemën e TVSH-së, ndërsa numri i OSHC-ve që nuk janë regjistruar në skemën e TVSH-së është 1,590. Në vitin 2020, katër (4) OSHC nga 121 të anketuara për raportin e Matricës së Monitorimit kanë deklaruar çregjistrimin nga skema e TVSH-së.

Nga 121 OSHC të anketuara, 24% ose 29 OSHC deklaruan se kishin një buxhet vjetor që varion nga 0 - 10,000 EUR, nga të cilat 7% nuk deklaruan të ardhura për vitin 2020.

Grafiku 4: Buxheti vjetor i OShC-ve për vitin 2020



Sipas udhëzimit të publikuar në vitin 2019 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi procedurën e rimbursimit të TVSH-së rreth fondeve të donatorëve të huaj për OShC-të, të gjitha marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të ratifikuara nga Parlamenti shqiptar ose marrëveshjeve për fonde të miratuara nga Këshilli i Ministrave, kualifikohen për rimbursimin e TVSH-së. Subjekti i rimbursimit të TVSH-së janë gjithashtu skemat e nën-kontraktimit. Bazuar në informacionin e marrë nga DPT, asnjë OShC nuk ka marrë rimbursim të TVSH-së.

Asnjë ndryshim ligjor nuk ka ndodhur në lidhje me ndërmarrjet sociale (NS). Në të njejtën linjë me gjetjet e raportit të mëparshëm të Matricës së Monitorimit, mjedisi ligjor mbi trajtimin fiskal nuk është favorizues për NS-të. Të pyetur nëse kanë përfituar ndonjë përfitim tatimor gjatë vitit 2020, 83% deklaruan se nuk kanë përfituar asnjë lloj përfitimi tatimor, ndërsa të tjerët nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Qeveria nuk krijoi skemë mbështetëse për OShC-të në lidhje me situatën pandemike COVID-19.

2.1.2. Lehtësirat mbi dhurimet individuale dhe korporatave

Ligji i vetëm që ofron disa lehtësira mbi dhurimet e biznesit është Ligji Nr. 7892/1994 "Për Sponsorizimin", i ndryshuar. Ligji njih si shpenzim të zbritshëm, deri në 5 (pesë) përqind të fitimit para tatimit, për botuesit e shtypit dhe botimet letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe aktivitetet kulturore dhe artistike deri në 3 (tre) përqind të fitimit para tatimit. Për aktivitetet sportive, në vitin 2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë propozoi disa ndryshime ligjore në Ligjin për sponsorizimin, ende në pritje të miratimit.

Bazuar në këtë ligj, u përcaktuan përjashtimet e mëposhtme nga tatimi mbi vlerën e shtuar:

1. Për sponsorizime në rastet e sporteve ekipore më të përhapura, u njihet zbritja deri në 20 për qind nga tatimi i fitimit, dhe
2. Për sponsorizimet në rastin e sporteve më pak të përhapura, një zbritje deri në 10% të fitimit nga tatimi i fitimit.

Për kompanitë me të ardhura vjetore të tatueshme mbi 100 milion lekë (rreth 805,000 EUR) shumat e sponsorizuara, për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislati në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, njihen si shpenzime të zbritshme deri në 3% të fitimit para - tatimit. Për të përfituar nga ky lehtësim, kompanitë e kualifikuara duhet të ndjekin procedura të veçanta për të marrë "autorizimin e sponsorizimit" nga DPT, duke siguruar disa dokumente për përfituesin e sponsorizimit dhe kompaninë, e cila bën sponsorizimin.

Ligjet në fuqi nuk njohin dhurimet individuale si të zbritshme nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Pas tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë në Nëntor të vitit 2019, Këshilli i Ministrave miratoi një Akt Normativ (Akti Normativ Nr. 5, datë 30.11.2019), dhe miratuar nga parlamenti me Ligjin Nr. 79/2019, sipas të cilit dhurimet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" brenda afatit të përcaktuar, dhe të transferuara në llogaritë e thesarit të shtetit, nuk njihen si shpenzime për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme. Në rastet kur dhurimet për shkak të shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit deri në nivelin 5%, në raport me fitimin para tatimit llogaritet sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të dhënat nga monitorimi i Partnerëve Shqipëri mbi dhurimin në vend për vitin 2020 tregojnë se vlera e përgjithshme e dhurimeve është 103,688,004 lekë (844,411 EUR). Sipas të dhënave të raportit vjetor, OShC-të ishin kanali i dytë më i shpeshtë i kanalizimit të dhurimit me 148 raste (34%).

Nga të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi i Matricës së Monitorimit me 121 OShC pjesëmarrëse, dhurimet e bizneseve dhe ato individuale përbëjnë 34% të burimeve financiare sipas OShC-ve të anketuara (13% dhurime të bizneseve dhe 21% dhurime individuale).

Kutia 3: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

2.2.a. Numri dhe lloji i dhurimeve për OShC-të nga dhurues individualë dhe të korporatave (specifikuar në vlera monetare)

2.2.b. Cilësia dhe zbatueshmëria / 'implementimi' i përfitimeve tatimore për dhurimet individuale dhe të korporatave të përcaktuara nga legjislacionet dhe rregulloret (përfshirë detajimin e llojeve të dhurimeve të zbritshme)

Të dhënat nga monitorimi i Partnerëve Shqipëri mbi dhurimin në vend për vitin 2020 tregojnë se vlera e përgjithshme e dhurimeve është 103,688,004 lekë (844,411 EUR). Sipas këtij raporti vjetor, OShC-të ishin kanali i dytë më i shpeshtë i kanalizimit të dhurimit me 148 raste (34%).

Ligjet ekzistuese nuk i njohin dhurimet individuale si të zbritshme nga tatimi për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale. Ligji Nr. 79/2019, sipas të cilit dhurimet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" brenda afatit të përcaktuar, dhe të transferuara në llogaritë e thesarit të shtetit, nuk njihen si shpenzime për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme. Në rastet kur dhurimet për shkak të shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit deri në nivelin 5%, në raport me fitimin para tatimit llogaritet sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nënfusha 2.2. Mbështetja e shtetit

2.2.1. Financimi Publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve

Për vitin 2020, ka regres mbi transparencën e mbështetjes së shtetit për mbështetjen e OSHC-ve.

Një nga masat nën Prioritetin 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve, në përputhje me praktikën e mira të BE-së është: Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OShC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime. Ka tre aktivitete të planifikuara për t'u zbatuar në mënyrë që të përmbushet kjo masë, dy prej të cilave do të duhej të përfundonin në vitin 2019, të tilla si 1) kryerja e analizës së mangësive ligjore, 2) identifikimi i ligjeve që kanë nevojë për ndryshim, dhe 3) ndryshimi dhe miratimi i legjislacionit është planifikuar për vitin 2022. Asnjë nga aktivitetet nuk ka përfunduar. Si rezultat, masa 8: sigurimi i informacionit të plotë për mundësitë e financimit publik për programet e OShC-ve, i planifikuar për vitin 2020 nuk është arritur.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është mekanizmi kryesor publik në nivel kombëtar që ofron mbështetje financiare për OSHC-të. Mandati i AMSHC-së është të mbështesë zhvillimin institucional të shoqërisë civile në vend, të sigurojë fonde për nismat sektoriale në përputhje me strategjinë e saj të hartuar përmes një procesi konsultativ me sektorin dhe të sigurojë bashkë-financim për projektet e financuara nga BE-ja. Financimi publik i akorduar nga AMSHC në vitin 2020 u ul me gati 40% krahasuar me vitet e mëparshme. Bazuar në informacionin e siguruar nga AMSHC-ja, fillimisht për vitin 2020 buxheti i AMSHC-së për të mbështetur OSHC-të në formë granti ishte afërsisht 100 milion lekë (afërsisht 825,000 EUR), por pas rishqyrtimit të tij, buxheti i miratuar ishte 61,000,000 lekë (rreth 491,000 EUR).

Gjatë vitit 2020, vetëm një thirrje (e vogël) për projekt propozime u publikua nga Agjencia. Në fillim të vitit, AMSHC shpalli thirrjen për projekt propozime për OShC-të të fokusuar në katër fusha prioritare: zhvillimi social dhe shërbimet sociale; lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor i publikut; mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe integrimi. Për shkak të pandemisë COVID-19, thirrja për projekt propozime u anulua dhe AMSHC-ja publikoi një thirrje tjetër në qershor me një buxhet të reduktuar, ku çështjet prioritare ishin kryesisht adresimi i shërbimeve dhe aktiviteteve në përgjigje të situatës së krijuar nga COVID-19. Rreth 88 OShC aplikuan në këtë thirrje (47 aplikime për bashkë-financim të projekteve të financuara nga BE), nga të cilat 46 OShC-ve (21 për bashkë-financim të projekteve të financuara nga BE) iu akordua një grant²⁶. Thirrja nuk përmbante informacion mbi shumën minimale të madhësisë së grantit, ndërsa shuma maksimale ishte deri në 1 000 000 lekë (afërsisht 8000 EUR). Edhe për këtë vit, Agjencia nuk akordoi asnjë grant për zhvillim institucional të OSHC-ve.

Një burim tjetër financimi publik për OShC-të është Ministria e Kulturës. Ministria publikoi një

²⁶ Informacioni është marrë nga faqja në internet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile [Online], AMSHC

thirrje për projekt propozime në vitin 2020 për projekte kulturore, në të cilën mund të aplikonin persona fizikë, juridikë si dhe OSHC-të.²⁷ Udhëzimet e publikuara në faqen në internet të ministrisë ofronin informacion mbi madhësinë minimale dhe maksimale të grantit, por nuk kishte informacion mbi shumën e përgjithshme të buxhetit të ndarë për këtë thirrje²⁸. Bazuar në njoftimin mbi rezultatet e fazës së parë të vlerësimit të projekt propozimeve të paraqitura, publikuar nga ministria,²⁹ u dorëzuan 148 projekt propozime, nga të cilat 43 projekt propozime kaluan fazën e parë. Në vijim të këtij njoftimi, në faqen e ministrisë nuk u vu asnjë informacion në dispozicion të publikut mbi rezultatet e kësaj thirrjeje. Gjithashtu, ministria nuk iu përgjigj kërkesës të dërguar për informacion.

Fondi i Lotarisë Kombëtare publikoi një thirrje për projekt propozime në vitin 2020³⁰. Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion në faqen zyrtare internetit, 5 projekt propozime u përzgjedhën fituese, ndër të cilat 3 projekt propozime ishin nga OSHC-të³¹. Mungoi informacioni mbi shumën e mbështetjes financiare të dhënë për secilin projekt dhe fokusi i projekteve të financuara.

Siç përcaktohet në Ligjin 39/2019 "Për Administrimin e Pasurive Të Sekuestruara dhe të Konfiskuara"³² Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara lejohet të krijojë një fond të veçantë të aprovuar nga Ministria e Mbrojtjes për shpërndarjen dhe alokimin e tij tek subjektet dhe OShC-të³³. Për vitin 2020, Agjencia krijoi një fond prej 93.4 milion lekë (afërsisht 756,000 EUR), nga të cilat 80% iu akordua entiteteve publike përfituese, si Policia e Shtetit dhe Struktura E Posaçme për Luftën Kundër Korrupsionit Dhe Krimin Të Organizuar - SPAK. Përqindja e mbetur (20%) iu akordua projekteve të organizatave të shoqërisë civile. Në dhjetor 2020, AAPSK publikoi një thirrje për projekt propozime që synonte OSHC-të me një buxhet të përgjithshëm prej 18,680,000 lekë (rreth 153,000 EUR)³⁴. Thirrja qëndroi e hapur për katër javë dhe OShC-të fituese do të zgjidhen vitin e ardhshëm.

Siç është paraqitur në Grafikon 6, 43% e të anketuarve janë dakord se financimi publik nuk plotëson nevojat e OShC-ve, 20% e numrit të përgjithshëm të OShC-ve të anketuara janë dakord plotësisht dhe vetëm 9% nuk janë dakord.

²⁷ <https://kultura.gov.al/hapen-thirrjet-per-projekte-kulturore-per-vitin-2020/>

²⁸ <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/1.-Udhezuesi-i-Thirrjes-2020-4-1.docx>

²⁹ https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/Njoftimi-per-web_Projektet-propozimet_Faza-II.docx-2.docx

³⁰ <https://lotaria.al/wp-content/uploads/2020/03/Njoftimi-per-Pjesemarrje-Viti-2020.pdf>

³¹ <https://lotaria.al/kreu/ceshtjet-e-mira/>


³² Ligji 39/2019 "Për Administrimin E Pasurive Të Sekuestruara Dhe Të Konfiskuara" [Online]

<http://parlament.al/Files/Akte/20190624141111ligj%20nr.%2034,%20dt.%2017.6.2019.pdf>

³³ Idem, neni 25


³⁴ [https://www.facebook.com/aapskalbania/?_cft__\[0\]=AZXyTrv-dagzbpvZKuhqEjH-8ry1_5A-PY-MKxYe5GD0qD5DZZ_N3vEqKn9ghtEWvqIH1rzBbBnZbPpA5iphwwy-5pMUOyrsanZaczKVp1HujH_7IcnmKQsggmJjL3s23OoonRkAqPmyXAqyFcw7ZD8&__tn__=-UC%2CP-R](https://www.facebook.com/aapskalbania/?_cft__[0]=AZXyTrv-dagzbpvZKuhqEjH-8ry1_5A-PY-MKxYe5GD0qD5DZZ_N3vEqKn9ghtEWvqIH1rzBbBnZbPpA5iphwwy-5pMUOyrsanZaczKVp1HujH_7IcnmKQsggmJjL3s23OoonRkAqPmyXAqyFcw7ZD8&__tn__=-UC%2CP-R)

Grafiku 6: Vlerësimi i OShC-ve për financimin publik




Të pyetur mbi llojin e mbështetjes nga shteti të përfituar në vitin 2020 nga institucionet qendrore dhe lokale (17% nga qeveria vendore dhe 10% nga qeveria lokale), shumica e OShC-ve (50%) kanë përfituar "grante për projekte ose aktivitete specifike", të ndjekura nga "kontrata shërbimi" dhe "bashkëfinancim për projekte të BE-së apo donatorëve të tjerë" me 17%, siç tregohet më poshtë në grafikun 7.

Grafiku 7: Llojet e mbështetjes së shtetit gjatë vitit 2020



Mbi mbështetjen nga shteti për të lehtësuar pasojat e situatës pandemike në veprimtarinë e OShC-ve, 23% nga 121 OShC të anketuara deklaruan që kanë marrë fonde shtesë për të përballuar situatën pandemike të krijuar nga COVID-19. Nga ky anketim i OShC-ve, vetëm 2% deklaruan se kishin marrë fonde shtesë nga AMSHC-ja dhe Bashkia e Tiranës, 21% e tyre janë mbështetur nga donatorët dhe 5% e tyre nga dhurimet individuale dhe të sektorit privat. Lidhur me format e mbështetjes së shtetit në përgjigje të COVID - 19, 15 nga 121 OSHC të anketuara (12% e kampionit) deklaruan se kishin përfituar nga shtyrja e afateve të raportimit. Po i njëjti numër i OShC-ve deklaruan se kanë përfituar nga shtyrja e afateve të pagimit të detyrimeve tatimore.

Grafiku 8: Format e mbështetjes së shtetit në përgjigje të COVID – 19



2.2.2. Shpërndarja e fondeve publike

AMSHC-ja ka një rregullore të qartë, përmes së cilës kryhet i gjithë procesi i shpalljes së procedurës së dhënies së grantit dhe përzgjedhjes së projekteve që mbështeten. Shpallja për procedurën është publike dhe ofron kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur (më shumë se 30 ditë) dhe për të dorëzuar projekt propozimin dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Megjithatë, 40% e OShC-ve të anketuara vlerësojnë se kërkesat e aplikimit nuk janë të lehta për tu përmbushur. Kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e projekt propozimeve vihen në dispozicion të publikut nga momenti i publikimit të thirrjes. Përveç kësaj, rregullat e konfliktit të interesit janë të përshkruara qartë në rregulloren e brendshme të AMSHC-së³⁵. Çdo vit para publikimit të thirrjes për projekt propozime, AMSHC organizon konsultime me OShC-të për të përcaktuar fushat prioritare të thirrjes. Procesi i konsultimit në vitin 2020 (në lidhje me thirrjen e parë që u anulua) u organizua në internet/online ku OShC-të u ftuan të dërgojnë sugjerimet e tyre me email brenda tre javësh, dhe nëpërmjet takimeve në shtatë qytete. Pavarësisht kësaj,

³⁵ "Procedurat E Brendshme Mbi Financimin Me Grante", AMSHC, Dhjetor 2016 [Në internet]
<http://www.amshc.gov.al/web/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

kur u pyetën në lidhje me nivelin e tyre të dakordësisë me deklaratën "OSHC-të janë të përfshira në përcaktimin e përparësive të financimit publik", 38% e OSHC-ve të anketuarve nuk janë dakord dhe 17% e tyre nuk janë fare dakord.

Transparenca e shpërndarjes së fondeve publike mbetet një pikë e dobët, pasi 44% e OSHC-ve të anketuara u përgjigjën se vendimet për shpërndarjen e fondeve nuk janë të drejta.

2.2.3. Përgjegjshmëria, Monitorimi dhe Vlerësimi i Financimit Publik

Dokumentat e vetëm ligjorë në dispozicion të publikut dhe të njohura për OShC-të që rregullojnë përgjegjshmërinë, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve publike janë ato të AMSHC-së. Ligji³⁶ dhe Rregullorja e AMSHC-së mbi procedurat e financimit të granteve³⁷ kanë rregulla të qarta se si do të vlerësohet dhe monitorohet financimi i projekteve, dhe janë një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit / procesit të shpërndarjes. Të gjithë përfituesve të fondeve publike u kërkohet të paraqesin raporte që detajojnë shpenzimin e fondeve të marra.

Nga monitorimi i të gjitha faqeve zyrtare online të institucioneve të identifikuar publike që ofrojnë mbështetje financiare për OShC-të (përfshirë AMSHC-në), rezultoi re se nuk ka raporte vlerësimi mbi impaktin e fondeve publike të shpërndara tek OShC-të. Sipas të dhënave të sondazhit të raportit të Matricës së Monitorimit, 25 nga 32 OShC që kishin përfituar fonde publike gjatë vitit 2020, kanë qenë subjekt i monitorimit nga autoritetet shtetërore për zbatimin e projekteve të mbështetura përmes fondeve publike. Të gjithë deklaruan se monitorimi ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara paraprakisht.

2.2.4. Mbështetja jo-financiare


Nuk ekziston një kuadër ligjor që autorizon autoritetet publike të ofrojnë mbështetje jo-financiare për OShC-të. Pavarësisht, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues dhe rregulloret e brendshme që rregullojnë funksionimin e institucioneve shtetërore, disa prej tyre kanë ofruar një mbështetje të tillë për OShC-të, por kjo ka qenë shumë e kufizuar, pasi vetëm 12% e OSHC-ve të anketuara (14 nga 121 OSHC-të e anketuara) kanë përfituar nga kjo lloj mbështetjeje.

OSHC-ve gjithashtu iu kërkua të japin vlerësimet e tyre në disa nga elementet e mbështetjes shtetërore jo-financiare, siç paraqitet më poshtë në grafikun 8. Vlen të theksohet se 50% e OSHC-ve nuk kanë një përgjigje për të gjitha pyetjet çka reflekton nivelin e tyre të informimit dhe tregon se ato nuk kanë informacion mbi mundësinë për të përfituar nga mbështetja jofinanciare shtetërore.

³⁶ Ligji Nr. 10093, datë 9.3.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile"[Online] http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/LIGJ_Nr._10093_date_9.3.2009.pdf

³⁷ Rregulloret mbi Procedurat e Financimit me Grante [Online] <http://www.amshc.gov.al/web/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

Grafiku 9: Mbështetja jo-financiare për OSHC-të në vitin 2020



Kutia 4: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

Rezultati 2.4.a. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me sigurimin e fondeve në aspektet e transparencës, paanësisë dhe mosdiskriminimit

- Financimi publik në mbështetje të OSHC-ve nuk plotëson nevojat e OSHC-ve. Bazuar në vëzhgimin me 121 OSHC, (42% e OSHC-ve nuk janë dakord që fondet publike u përgjigjen nevojave të OSHC-ve, dhe 21% nuk janë fare dakord).
- Vendimet mbi shpërndarjen e fondeve nuk konsiderohen të drejta nga 30% e OSHC-ve të anketuara.

Rezultati 2.4.c Cilësia e kuadrit të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (duke u përqëndruar në dokumentin procedural)

- Nuk ka kornizë të unifikuar për të gjitha fondet publike që janë në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile. Prandaj, të gjitha institucionet publike hartojnë dhe zbatojnë kornizën e tyre bazuar në legjislacionin dhe praktikën në fuqi.
- Në lidhje me fondet publike shpërndarë tek OSHC-të përmes AMShC-së, ekziston një kuadër rregullues ligjor në dispozicion të publikut me rregulla dhe procedura mbi shpërndarjen dhe menaxhimin e fondit vjetor. Për shkak se ky fond nuk mbështetet nga një strategji afatgjatë dhe të mirë-planifikuar, ai nuk ka arritur të adresojë nevojat kryesore të sektorit.

Nënfisha 2.3. Burimet njerëzore


2.3.1. Burimet njerëzore

Legjislacioni në fuqi nuk stimulon, por as nuk pengon punësimin në OShC. Kodi i Punës dhe i gjithë legjislacioni përkatës i trajtojnë të gjithë të punësuarit në mënyrë të barabartë, përfshirë të punësuarit e OShC-ve. Pavarësisht kësaj, OShC-të nuk u përfshinë në "Paketat COVID - 19" të miratuara nga Qeveria në përgjigje të situatës pandemike COVID-19, me arsyetimin se veprimtaria e tyre nuk u prek nga masat e marra.

Sipas informacionit të marrë nga DPT, janë rreth 9,793 të punësuar në sektor. Asnjë informacion nuk u dha në lidhje me të punësuarit me kohë të plotë, të punësuarit me kohë të pjesshme, edhe pse këto informacione mblidhen përmes deklarimeve që OSHC-të i dorëzojnë pranë këtij institucioni.


Bazuar në gjetjet e vëzhgimit me OShC-të, 10% e tyre deklaruan se nuk kanë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 59% kanë 1 - 5 të punësuar me kohë të plotë, ndjekur nga 14% e OShC-ve që kanë 11-15 të punësuar. Organizatat me më shumë se 30 të punësuar janë degë të organizatave ndërkombëtare dhe me shtrirje kombëtare të veprimtarisë së tyre.

Grafiku 10: Përqindja e të punësuarve me kohë të plotë në OSHC




Pjesa më e madhe e OShC-ve të anketuara, përkatësisht 26% nuk kanë të punësuar me kohë të pjesshme, ndërsa 61% kanë 1 -5 të punësuar me kohë të pjesshme, ndërsa 39% e OSHC-ve kanë kontraktuar nga 1 në 5 ekspertë gjatë vitit 2020, ndjekur nga 24% ose 29 OSHC nuk kanë kontraktuar ndonjë ekspert, siç tregohet më poshtë në grafikët 11 dhe 12.

Grafik 11: Përqindja e të punësuarve me kohë të pjesshme në OSHC



Grafik 12: Ekspertë të kontraktuar nga OShC-të



2.3.2. Vullnetarizmi në OSHC


Vullnetarët janë një pjesë shumë e rëndësishme e burimeve njerëzore të OSHC-ve. Në vitin 2019, paketa ligjore mbi vullnetarizmin u kompletua me aktet ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 45/2016 për Vullnetarizmin, kuadri kryesor ligjor për rregullimin e vullnetarizmit në Shqipëri që synon të rrisë angazhimin dhe pjesëmarrjen e vullnetarëve në jetën shoqërore. Siç dëshmohet dhe raportohet rregullisht nga OShC-të që punojnë me vullnetarë, ligji paraqet një seri pasigurish dhe një mungesë qartësie që ka ndikuar negativisht në përfshirjen e vullnetarëve në OSHC. Duke marrë në konsideratë vitin 2020, QKBSHC në Shqipëri përgatiti një opinion ligjor mbi ligjin për vullnetarizmin dhe zbatimin e tij. Opinions ofron gjetje dhe rekomandime konkrete për ndryshime në ligj. Ligji përpiqet të rregullojë angazhimin vullnetar, ndërkohë që ky

angazhim bazohet në vullnetin e secilit individ në çdo kohë që ai / ajo mendon se mund të kontribuojë në të mirën dhe interesin publik. Pra, në këtë aspekt, ligji duhet të shmangë rregullimin e vullnetarizmit në kuptimin që vullnetarëve t`u duhet të regjistrohen për të ushtruar këtë vullnet. Siç përcaktohet në ligj, Regjistri i Vullnetarëve, i parashikuar në ligj, duhet të jetë njohja e kontributit të vullnetarëve në shoqëri dhe shmangia e keqpërdorimit të mundshëm për përfitime financiare dhe fiskale.

Natyra e marrëdhënieve juridike dhe kontraktuale midis vullnetarit dhe organizatës pritëse duhet të sqarohet në lidhje me detyrimet tatimore të palëve përkatëse, tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet shoqërore. Për më tepër, ligji duhet të sigurojë mbrojtje efektive për vullnetarët duke prezantuar skema të mbështetjes nga shteti, siç janë pagesa e kontributeve sociale dhe shëndetësore për vullnetarët. Ligji gjithashtu duhet të jetë fleksibël për vullnetarizmin masiv të tilla si fushatat e pastrimit të mjedisit, vullnetarizmi në raste të forcës madhore, etj. Kjo çështje ishte planifikuar fillimisht të adresohet në vitin 2020 si pjesë e Planit të Veprimit të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Por asnjë nga këto masa nuk është adresuar deri më tani.

Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se 42% e OShC-ve kanë angazhuar 1-10 vullnetarë dhe vetëm 2% kanë angazhuar mbi 300 vullnetarë gjatë vitit 2020. OShC-të që përfshijnë një numër të lartë vullnetarësh janë organizata që janë krijuar dhe punojnë për të rinjtë, aktive në fushata masive ndërgjegjësimi - si dhe ato organizata që advokojnë për të rinjtë.

Grafik 13: Përfshirja e vullnetarëve në OSHC-të e intervistuar



2.3.3. Edukimi Jo-Formal

Në Ligjin 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"

përkufizimi i të nxënit joformal është mësimnxënia që përfshihet në aktivitete të planifikuara dhe jo domosdoshmërisht të zhvilluara si forma mësimore, por që përmbajnë përvoja të rëndësishme të të mësuarit. Edukimi jo-formal, sipas Ligjit 75/2019 "Për Rininë"³⁸, përcaktohet si një aktivitet i organizuar dhe përshtatur për të rinjtë, i planifikuar jashtë sistemit arsimor zyrtar, bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, mbi parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të mësuarit, përmes të cilave ata zhvillojnë potencialin personal, pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe qasjen në tregun e punës (neni 3, pika b). Vullnetarizmi trajtohet si një temë e veçantë, pjesë e edukimit qytetar në shkollë.

OSHC-të përfshihen në edukimin jo-formal përmes ofrimit të programeve për ngritjen e kapaciteteve, kurseve dhe shërbimeve profesionale. Mbi 319 OShC janë të pajisura me licencë dhe ofrojnë shërbime edukuese dhe sociale.³⁹

Kutia 5: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

Sipas informacionit të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka 9,793 të punësuar që punojnë në OSHC. Nuk ka informacion të ndarë për të punësuarit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. 59% e OShC-ve të anketuara kanë 1-5 punonjës të punësuar me kohë të plotë dhe 69% të punësuar me kohë të pjesshme.

Rezultati 1.2.d. Numri i vullnetarëve në OShC sipas llojit të OShC-së/vektorit

Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve që punojnë në OSHC. 64% e organizatave të anketuara kanë 0 - 10 vullnetarë. Organizatat që krijohen dhe përfaqësohen nga individë të rinj janë kryesisht organizata që kanë mbi 60 vullnetarë. Këto organizata zhvillojnë fushata massive ndërgjegjësimi, advokojnë dhe mbrojnë të drejtat e të rinjve, grave dhe fëmijëve.

Rezultati 1.2.f. Cilësia e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor për vullnetarizmin është plotësuar me miratimin e akteve ligjore por nuk është i favorshëm për OShC-të që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetare, për shkak të vështirësive dhe pasigurive në përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të gjëritjes.

³⁸ <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191107152923ligj%20nr.%2075,%20dt.%204.11.2019.pdf>

³⁹ Panoramë e ekosistemit të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019 [Online] <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/04/Overview-of-Social-Enterprises-Eco-system-in-Albania.pdf>

Fusha 3: Marrëdhënia Shtet-OSHC

Nënfusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

3.1.1. Politikat shtetërore dhe strategjitë për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile

Strategjia kryesore për zhvillimin dhe bashkëpunimin e shtetit me shoqërinë civile është Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023, rishikuar dhe miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.7.2019.

Dy vite pas miratimit të Udhërrëfyesit të rishikuar, shumica e masave të planifikuara për tu realizuar deri në fund të vitit 2020 nuk janë zbatuar. Në maj të vitit 2020, AMShC-ja publikoi një pyetësor në internet për të mbledhur pikëpamjet e OShC-ve⁴⁰ në lidhje me përmirësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit mbi Udhërrëfyesin. Rezultatet nuk janë bërë ende publike.

Në bazë të Udhërrëfyesit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është caktuar të zhvillojë, ngritjen e një mekanizmi të brendshëm përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve, i cili do të lehtësonte raportimin dhe kontributin e agjencive shtetërore përgjegjëse për zbatimin e masave të Udhërrëfyesit. Sistemi i planifikuar të krijohej në vitin 2019, nuk është krijuar ende dhe asnjë raport nuk është përgatitur dhe publikuar mbi progresin e zbatimit të Udhërrëfyesit.

Megjithëse AMShC zhvilloi një proces online rreth perceptimeve të OShC-ve në lidhje me Udhërrëfyesin, ai mbetet një dokument krejtësisht i panjohur nga OShC-të. Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se 47% e 121 OShC-ve kanë dijeni për ekzistencën e tij, por nuk kanë informacion mbi përmbajtjen, kursë 25% e OShC-ve nuk janë në dijeni të një dokumenti të tillë. Vetëm 28% kanë dijeni si për dokumentin ashtu dhe përmbajtjen e tij.

3.1.2. Institucionet dhe mekanizmat për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile

Referuar strukturave dhe mekanizmave për dialog dhe bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe institucioneve publike, dy janë mekanizmat kryesorë: Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe

⁴⁰ https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3483551731771038&id=506935452766029

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), i themeluar në 2016, është një organ kolegjal këshillimor që synon të garantojë bashkëpunimin institucional ndërmjet Shtetit dhe OShC-ve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë me pjesëmarrje dhe rritjes së transparencës nëpërmjet përfshirjes më të qëllimshme të shoqërisë civile në këtë proces. Në përputhje me Ligjin "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile,"⁴¹ Këshilli përbëhet nga 27 anëtarë, 13 përfaqësues nga institucione qeveritare, 13 përfaqësues nga OSHC-të dhe 1 përfaqësues nga Këshilli Ekonomik Kombëtar.

Në Shtator 2020, KKShC-ja zgjodhi katër anëtarë të rinj nga shoqëria civile duke zëvendësuar ata, të cilëve u përfundoi mandati.⁴² Procesi i përzgjedhjes u krye në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile⁴³, përmes votimit online. AMShC-ja, e cila vepron si sekretariat, publikoi thirrjen për nominime, duke ftuar OShC-të të paraqesin propozimet e tyre për anëtarët e rinj të KKShC-së. Rezultatet u publikuan në faqen zyrtare të internetit të AMShC-së.

Në vitin 2020, sikundër është publikuar në faqen e internetit të AMShC-së, Këshilli zhvilloi dy takime për të diskutuar projektligjin për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse dhe Planin e Veprimit të Partneritetit të Qeverisë së Hapur për Shqipërinë 2020-2022. Përfaqësimi efektiv dhe përfshirja e këndvështrimit të sektorit të OShC-ve në punën e Këshillit vijojnë të mbeten pika të dobëta.

Kjo reflektohet gjithashtu në opinionin e OShC-ve të vëzhguara, ku 65% e OShC-ve deklaruan se nuk kanë informacion mbi punën e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Gjithashtu, kur u pyetën nëse puna e KKShC-së bazohet në rekomandimet dhe kontributin e OShC-ve, 32% u përgjigjën "Nuk e di" dhe 27% u përgjigjën "Nuk jam dakord".

Masa në lidhje me ndryshimin e Ligjit për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për të reflektuar numrin e përfaqësuesve dhe emrin e linjave të ministrive pjesë e Këshillit në mënyrë që të sigurohet balanca e duhur e përfaqësimit, nuk është zbatuar.

Një strukturë e rëndësishme, në kuadër të antarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE), i krijuar nga Parlamenti, që synon të promovojë dhe garantojë bashkëpunimin gjithëpërfshirës midis forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, dhe të rrisë transparencën në vendimmarrje për çështjet e integritetit. Gjatë vitit 2020, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian ka organizuar 5 takime periodike⁴⁴, dhe dy takime rajonale me OShC për të rritur informacionin mbi rolin e KKIE. KKIE sikundër dhe KKShC-ja nuk është ende një strukturë efektive drejt arritjes së misionit të saj. KKIE ka zbatuar vetëm gjysmën e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2020. Këshilli vuan nga mungesa e përfaqësimit me bazë të gjerë të OShC-ve në nivel kombëtar. Të gjithë 15

⁴¹ FZ 200/2015, Ligji nr. 119/2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" [Online] <https://qbz.gov.al/share/q9X3GXAjROI2QTN3otTFAA>

⁴² https://drive.google.com/file/d/189rmOpJqXmnqD7UrTpdA9N-oysGIpnK0/view?usp=drive_web

⁴³ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e AMShC-së [Online]

<https://drive.google.com/file/d/1xOY3QQRyBRIK0EVimImS8IojH6ab00Xj/view>

⁴⁴ <http://www.parlament.al/Files/Integrimi/Raporti%20i%20KKIE%20p%C3%ABr%20viti%202020.pdf>

përfaqësuesit e OSHC-ve të cilët janë pjesë e Këshillit, janë me seli në Tiranë⁴⁵.

Masa 2.9 e Udhërrëfyesit planifikon që çdo ministri të caktojë personat e kontaktit për OShC-të deri në fund të vitit 2020. Asnjë informacion në lidhje me emërimet të tilla nuk është bërë publike në faqet zyrtare të ministrive përkatëse. Vetëm parlamenti ka një koordinator për OShC-të dhe informacioni i kontaktit është publik në faqen zyrtare të internetit.

Nënfusha 3.2. Përfshirja në procesin e politik - bërjes dhe vendimmarrjes

3.2.1. Standardet për përfshirjen e OShC-ve

Prioriteti 2 i Udhërrëfyesit: Institucionet qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OShC-të, ka nëntë (9) masa dhe 25 aktivitete, por gjithsesi përfshirja e OShC-ve në hartimin e politikave dhe vendimmarrje mbetet e ulët.

